

BESA HOXHA BEQIRI

**PORTRETIZIMI I FISHTËS NGA BALA NË PERIUDHA
TË NDRYSHME KOHORE**

Hyrje

Në këtë punim janë bërë përpjekje për dokumentimin e përkatësisë autoriale të kapitullit për Gjergj Fishtën në *Historia e letërsisë shqipe 1912-1939*, apo pjesën e tretë të pabotuar të *Historisë së letërsisë shqipe*, në krahasim me dokumentacionin e gjetur dhe monografinë e botuar më 1998. *Të kesh në dorë kapitullin për Gjergj Fishtën të dorëshkrimit, variantet e ndryshimit të tij në tre faza, si dhe dokumentin për Gjergj Fishtën, të gjetura në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë të Tiranës, dhe nga ana tjetër monografinë e botuar për Gjergj Fishtën, që të gjitha këto shkrime të Vehbi Balës, është një proces interesant i analizës, por edhe një punë që kërkon përkushtim ...*¹ Nuk duhet të lihet anash edhe dosja², në të cilën, edhe pse shkruan kapitulli VII, kapitull ky që është për Gjergj Fishtën, ashtu siç është në dorëshkrim, sërish ka ndryshime. Dorëshkrimi i gjetur *Historia e letërsisë shqipe 1912-1939*, dorëshkrimi ky i viteve '60 ka bërë që të hapen disa çështje interesante për studim.

Në *Parathënien* e monografisë *Gjergj Fishta* të Vehbi Balës, parathënie kjo e shkruar nga djali i autorit të veprës Agron Bala, që në fillim thuhet: *Monografia që po i paraqitet sot lexuesit është shkruar plot tridhjetë vjet më parë, më 1961. Punën për hartimin e saj, autori e filloi më 1958.*³ Ky element nuk është i vetmi që përdoret për të dëshmuar autorësinë e Vehbi Balës dhe vetëm

¹ B. Hoxha Beqiri, *Një histori letërsie e ndaluar; Si u ripërfundua Fishta*, Konica dhe Skiroi nga "Historia e letërsisë shqipe", SHB Naimi, Tiranë, f. 182-183.

² Dokument arkivor; Dosja ku mungojnë numri dhe viti, titulli *Gj. Fishta (kapitulli i tekstit të letërsisë)*, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë.

³ V. Bala, *Gjergj Fishta; Jeta dhe vepra, Shkodër 1961*, Shtëpia Botuese Ombra GVG, Tiranë, 1998.

autorësia nuk është qëllim i punimit. Krahas kësaj, do të bëhet përpjekje të analizohet ndryshimi i bërë në versionet e gjetura⁴, versionit të kapitullit përfundimtar para korrigjimit të fundit, version ky i dorëzuar për botim, si dhe qasjes në monografi. Të gjitha këto mund të ndriçojnë ndikimin e censurës në vitet 1958 – 1961, gjegjësisht 1958-1968, vit ky i fundit, kur dorëshkrimi *Historia e letërsisë shqipe 1912-1939* ishte në boca.

Në intervistën me profesorin Jorgo Bullo, në pyetjen rreth redaksisë së *Historisë së letërsisë shqipe 1912-1939* ai përgjigjet: *Vehbi Bala, Mark Gurakuqi, Dhimitër Shuteriqi kryeredaktor, Koço Bihiku redaktor. Po, natyrisht, shfrytëzuan monografitë e autorëve. Dihet si bëheshin atëherë monografitë. Pra, i jepnin për botim e pastaj shfrytëzoheshin nga redaksia.*⁵ Përveç krahasimit dhe ngjashmërive, apo përputhjes mes dorëshkrimit dhe monografisë së Balës, edhe dëshmia e profesorit të ndjerë Bullo ndriçon autorësinë e Balës, të qenit e tij pjesë e grupit punues të *Historisë së letërsisë shqipe*. Në mungesë, gjegjësisht mosgjetje të dokumentacionit arkivor rreth redaksisë dhe grupit punues të dorëshkrimit, intervista me personin i cili ka qenë i fundit, së bashku me Klara Kodrën⁶, të caktuar për kontrollimin e materialit para se të hynte në shtyp, ndihmon në ndriçimin e autorësisë. Me gjithë atë, përmendja e shfrytëzimit të monografive të gatshme në intervistën e përmendur, ka bërë që të analizohet më thellësisht materiali i gjetur. Krahasimi mes varianteve, faqe të së cilave janë edhe me daktiloshkrim, si dhe krahasimi mes tyre, dorëshkrimit dhe monografisë kanë qartësuar disa elemente.

⁴ Dokument arkivor; Versioni I-rë i kapitullit për Gjergj Fishtën, 83 faqe (faqe edhe me vetëm daktiloshkrim)

Versioni II-të i kapitullit të Gjergj Fishtës, 57 faqe, si dhe Versioni III-të i kapitullit për Gjergj Fishtën, 47 faqe (kopja 1), Arkivi i Institutit të Gjuhës dhe Letërsisë, Tiranë.

⁵ B. Hoxha Beqiri, *Një histori letërsie e ndaluar; Si u ripërjashtua Fishta, Konica dhe Skiroi nga "Historia e letërsisë shqipe"*, SHB Naimi, Tiranë, f. 279.

⁶ Sqarim: Pjesëmarrja e Klara Kodrës së bashku me Jorgo Bulon në korrigjimin e fundit të *dorëshkrimit* para se ai të hynte në botim, nuk është cekur vetëm nga Jorgo Bullo në intervistën me të, por edhe në bisedë me vetë Klara Kodrën.

Elementet e përputhjes dhe ndryshimet mes dorëshkrimit dhe monografisë (me theks në variantin e parë të dorëshkrimit)

Kapitulli për Fishtën në dorëshkrim ka 40 faqe, ndërsa monografia e botuar ka 165 faqe. Data, që qëndron në fund të dorëshkrimit, si datë e përpilimit të veprës nga Vehbi Bala është 15 shkurt 1961, ...⁷ Po të analizonim dokumentet e gjetura, pa e pasur monografinë me datën në fund të saj, nuk do të mund të vihej në përfundim se monografia e Balës është ajo e vitit 1961. Në dosjen me titull Gj. Fishta (kapitull i tekstit të letërsisë) gjatë analizës shihet se edhe këtu e kemi kapitullin VII (dhe dosja e ka vetëm këtë kapitull), kapitull ky për Gjergj Fishtë. Deri sa në dorëshkrimin *Historia e letërsisë shqipe 1912 – 1939* emërtimet e nëntitujve ndryshojnë nga monografia, në këtë dosje kemi mjaftë ngjashmëri. Kështu kemi ndarjet në: *Jeta, Veprat, Satira, Lirika, Lahuta e Malcisë, Drama, Arti dhe idetë e veprës* si dhe *Përfundimin*, nëntituj këto që i gjejmë edhe te monografia, te kapitulli mbi veprën letrare. Ndërkaq, te dorëshkrimi si dhe variantet te pjesa e veprave nuk bëhet ndarja sipas gjinive, por sipas veprave: *Anzat e Parnazit dhe Gomari i Babatasit, Mrrizi i zanave* i dhe *Lahuta e Malcisë*, do me thënë është shkuar në ndarje sipas titujve të veprave dhe jo gjinive letrare dhe tematike. Dramat janë të analizuara nën këtë titull. Është interesant fakti se titullin e *Lahutës së Malcis* e gjejmë me ë në fund dhe pa të (te dosja pa ë, ndërkaq në monografi, dorëshkrim dhe variante me ë). Duhet të ceket gjithashtu se në dosje gjendet firma e Koço Bihikut, redaktorit të *Historisë së letërsisë shqipe*, gjë që sjell në dilemë për ndryshimet e gjetura mes këtij dokumenti dhe dorëshkrimit, si dhe varianteve, aq më tepër pasi që në dosje gjejmë vetëm korrigjime teknike dhe ortografike.

Edhe gjatë krahasimit kemi pjesë, të cilat janë plotësisht të njëjta si në dorëshkrim, por kemi edhe shtesa dhe ndryshime. Megjithatë, një gjë është e qartë, se dorëshkrimi, as botimi, nuk janë plotësisht të njëjtë me kapitullin për Gjergj Fishtën të dorëshkrimit të *Historisë*

⁷ B. Hoxha Beqiri, *Një histori letërsie e ndaluar; Si u ripërfundua Fishta, Konica dhe Skiroi nga "Historia e letërsisë shqipe"*, SHB Naimi, Tiranë, f. 184.

së letërsisë shqipe.⁸ Ndryshimet janë të logjikshme, duke marrë parasysh hapësirën e trajtimit, mirëpo ka edhe elemente që të vënë në lajthitje. Kështu, gjatë procesit të krahasimit është bërë përqendrimi në analizën e veprave dhe poezive si dhe shembujve të tyre të shtjelluar.

Ekzistimi i tre varianteve të kapitullit mbi Gjergj Fishtën në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë në Tiranë, ka mundësuar studimin e pësimit të ndryshimeve gjatë procesit. *Monografia për Gjergj Fishtën e botuar nga djali i Vehbi Balës, Agron Bala, ka ndryshime me një dorëshkrim të gjetur të Vehbi Balës në arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë në Tiranë. Edhe pse dorëshkrimi i mungojnë 15 faqet e para, duket qartë se monografia e botuar ka pësuar ndryshime. Një gjë të tillë e sqaron edhe A. Bala në parathënien e monografisë: “kjo vepër ka tre variante që ndryshojnë nga njëri-tjetri qoftë në konceptim, qoftë në përfundimet e arritura. Sot, në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë gjendet vetëm kopja e variantit të fundit, që është njëkohësisht edhe varianti më i dobët: ai ka pësuar përcudnime të pabesueshme po ta krahasosh me dy variantet e para”⁹. Mirëpo, në Arkiv janë gjetur tre variante të kapitullit mbi Fishtën dhe asnjëri prej tyre nuk përputhet plotësisht me monografinë, edhe pse mund të vihet në përfundim autorësia e Vehbi Balës. Ndërkaq, monografia, e gjetur gjithashtu në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë në Tiranë siç është shkruar më 1961, siç thotë i biri i autorit. Çështja e ndryshimeve që janë bërë nga kjo monografi e hershme në monografinë e botuar shumë më vonë, mbetet çështje e një punimi tjetër.*

“Palokë Cuca” – krahasimet në dokumentet, dorëshkrim dhe monografi

Në pamundësi për shkak të gjatësisë së punimit, që të krahasohen detalisht për këtë punim të gjitha pjesët e kapitullit për

⁸ B. Hoxha Beqiri, *Një histori letërsie e ndaluar; Si u ripërfundua Fishta, Konica dhe Skiroi nga “Historia e letërsisë shqipe”*, SHB Naimi, Tiranë, f. 184.

⁹ B. Hoxha Beqiri, *Një histori letërsie e ndaluar; Si u ripërfundua Fishta, Konica dhe Skiroi nga “Historia e letërsisë shqipe”*, SHB Naimi, Tiranë, f. 181-182.

Gjergj Fishtë në *dorëshkrimin, monografinë, variantin e parë*, si dhe pjesëve të njëjta që janë gjetur, duke përfshirë edhe *dosjen*, është marrë vetëm pjesa e analizimit të poemës *Palokë Cuca*, me qëllim që të shihet se monografia me cilën prej dokumenteve tjera ka ngjajshmëri më tepër, apo pjesët që përputhen plotësisht.

Në të gjitha dokumentet, gjegjësisht dorëshkrimin dhe veprën e cekur, fillimi i pjesës për poemën ndryshon.

Në *dorëshkrim* fillimisht për nga ideja ndërlidhet poema satirike me vjershën *Bujari*. Menjëherë pas kësaj fillohet me subjektin, për të cilin thuhet se *është shumë i thjeshtë*.¹⁰

Ndërkaq, në versionin e parë të dorëshkrimit fillohet me trajtimin e temës së poemës. *Për nga tema e gjerë politike – shoqërore për nga problematika e gjerë e arti i portretizimit, për nga realizimi dhe stili i gjallë, për nga mjetet stilistike e gjuha politike, vepra “Palokë Cuca” është kulmi artistik i Fishtës në satirë*.¹¹ Kjo është pjesa e cila është fshirë dhe është bërë korrigjimi me daktiloshkrim, për ta lënë: *Nga rëndësia politike e temës realizimi i përgjithshëm artistik dhe karakteret e gjalle e plot jete që ... (fjalë e pakuptuar – BHB) ne te, “Palokë Cuca” është kulmi artistik i Fishtës në satirë*.¹² Me këtë shembull shihen edhe ndryshimet e bëra në versionin e parë.

Në monografia *Gjergj Fishta* analiza e poemës fillohet me citat nga libri *At Gjergj Fishta*, citat ky që përmbyllet me: *Aty do të flitet për gjithë jetën shoqërore shqiptare të kaluar, të sotme e të ardhme*¹³, fragment ky i asaj që i ka shkruar nga Parisi vetë Fishta një shoku të tij për *Palokë Cucën*.

Ndërkaq, te dosja fillimi është ndryshe. *Te “Palokë Cuca”, poeti ka për qëllim të paraqesë shkollën e huaj si fole të propagandës*

¹⁰ *Historia e letërsisë shqipe 1912-1939*, dorëshkrim; Arkivi i Institutit Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë, f. 132.

¹¹ Versioni i parë për Gjergj Fishtën (mungon faqja e parë), dokument; Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, f. 8.

¹² Versioni i parë për Gjergj Fishtën (mungon faqja e parë), dokument; Arkivi i Institutit Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë, f. 8.

¹³ Vehbi Bala, *Gjergj Fishta; Jeta dhe vepra, Shkodër 1961*, Shtëpia Botuese Ombra GVG, Tiranë, 1998, f. 97.

*antikombëtare dhe të tregojë fytyrën e përçmuar të asaj pjese të borgjezisë shkodrane, që, e shastisur nga fjalët e mësuesve fetar italian, arrinte gjer të mohojë atdheun dhe kombësinë e vet.*¹⁴

Fillimet e ndryshme në analizën e poemës dëshmojnë se monografia e botuar më 1998 nuk përputhet plotësisht me asnjërën nga dokumentet e tjera, e as dorëshkrimi, me gjithë faktin se qasja në shtjellim dhe analizë përcjell shumë elemente të njëjta, por të formësuara me ndryshime. Në të dy dokumentet, dorëshkrimi dhe monografia vazhdohet me subjektin/fabulën e poemës. Gjithashtu, qysh në shtjellimet e para vihet theks i posaçëm në të mësuarit e Palokës nga mësuesi italian (vetëm te monografia vihet në pah se mësuesi është shqiptar) që mos të quan veten shqiptar po shkodran.

Në versionin e parë të dorëshkrimit, ashtu si edhe në monografi kemi më tepër ilustrime me vargje të pjesëve të poemës. Në të shumtën e rasteve gjejmë vargjet e njëjta në që të dyja, mirëpo një pjesë e tyre në version janë fshirë (mbase edhe për shkak të vërejtjeve për përdorimin e shumtë të ilustrimeve me vargje) së bashku me pjesët e sqarimit, gjegjësisht analizës së tyre.¹⁵

Interesant është fakti se në versionin e parë është fshirë pjesa ku tregohet për satirizimin e Komisionit Letrare, pjesë kjo që është e analizuar dhe ilustruar edhe me vargje (pjesa më e madhe të njëjtat) si në monografinë e mëvonshme. Ndërkaq, që të dyja e kanë analizimin e personazheve, ndër to edhe të mësuesit shqiptar Jak Speci, gjë që bëhet vetëm këtu, mirëpo në version kjo pjesë është fshirë. E fshirë është edhe pjesa më e madhe e analizës së kritikës së nëpunësve e deputetëve, ndërsa është fshirë plotësisht pjesa ku analizohet kritika ndaj institucioneve juridike dhe pseudo intelektualëve, pjesë këto që janë të përfshira në monografi.

¹⁴ Dokument arkivor; Dosja ku mungojnë numri dhe viti, titulli *Gj. Fishta (kapitulli i tekstit të letërsisë)*, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, f. 151.

¹⁵ Nga diskutimet mbi maketin e “Historisë së letërsisë shqipe”; Vërejtje të përgjithshme, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, f. 1, “Jo komente, reçensione, sepse këto bëhen në antologji, por veprat e shkrimtarëve të paraqiten me pak fjalë ku të vihen në dukje ideja, qëllimi dhe vlera e veprës në lidhje me rrethanat e kushtet kur është shkruar ajo.”

Duke analizuar pjesën e caktuar të librit, dorëshkrimit dhe versionit të parë të dorëshkrimit, si dhe dosjes, nga vetë ilustrimet e përdorura, mënyra e qasjes dhe vlerësimit të Gjergj Fishtës, vihet në përfundim se Vehbi Bala është autor i kapitullit për Gjergj Fishtën në dorëshkrimin *Historia e letërsisë shqipe 1912 – 1939*, me elemente të dukshme në versionin e parë. Këtë e përforcon edhe fakti se disa pjesë të këtij versioni i gjejmë edhe në monografi dhe ato janë me shkronja italiane. Mirëpo, natyrisht se ka edhe ndryshime, pasurime dhe qasje të thelluar në monografi në krahasim me versionet dhe dorëshkrimin. Ndërkaq, monografia e vitit 1961 e autorit, nuk na lë fare dyshim mbi autorësinë e tij.

Pjesët me daktiloshkrim në variantin e parë të kapitullit për “Gjergj Fishtën”

Interesant për këtë studim është edhe versioni i parë i dorëshkrimit, i cili jo vetëm që është më vuliminoz, por ka, përveç ndërhyrjeve me daktiloshkrim në korrigjim të faqeve të shtypura, edhe faqe të tëra vetëm me daktiloshkrim, gjithsej njëmbëdhjetë. Sipas daktiloshkrimit, duket të jetë i njëjti shkrim, si në faqet që janë vetëm me daktiloshkrim ashtu edhe në korrigjimet e bëra në faqet tjera. Ndërkaq, në dosje, ku kemi firmën e Koço Bihikut, lihet përshtypje që kemi daktiloshkrim tjetër, edhe pse natyrisht se kjo iu mbetet ekspertëve për ta vërtetuar. Në bazë të kësaj, vijmë në përfundim se Vehbi Bala, jo vetëm që ka shkruar variantin e parë të kapitullit për Fishtën në dorëshkrim, por edhe ka punuar me korrigjimet, mbase në bazë të vërejtjeve (gjë që nuk mund të vërtetohet pa i gjetur dokumentet e proceseve të ndryshme në kritikë dhe vërejtjet gjatë procesit të hartimit të *Historisë së letërsisë shqipe 1912 – 1939*. Dokumentacioni i vërejtjeve të gjetura, apo edhe procesverbaleve dhe recensioneve mendohet se nuk është i plotë.

Përfundimi

Gjatë punës kërkimore, krahasimi i varianteve të ndryshme me monografinë e botuar solli deri te disa elemente:

- në proces të punës, që nga varianti i parë për Gjergj Fishtën, e deri te ai që ishte përfshirë në dorëshkrimin e *Historisë së Letërsisë Shqipe*, dorëshkrimit që hyri në botim, kishte shumë ndryshime dhe ndërhyrje me daktiloshkrim;
- ndërhyrjet janë tematike, por gjithashtu edhe të aspektit të të përmbledhurit, gjegjësisht shkurtimeve, për shkak të gjatësisë së variantit të parë;
- në bazë të dokumentacionit ekzistues, daktiloshkrimit në variante, kemi elemente që na sjellin në përfundim se Vehbi Bala jo vetëm që shkroi kapitullin për Gjergj Fishtën në *Historinë e Letërsisë Shqipe 1912 – 1939*, por gjithashtu është marrë edhe me korrigjimet dhe ndryshimet (të bëra vetë, me qëllim të përmbledhjes apo sipas sugjerimeve).

Sa i përket çështjes së sugjerimeve nuk mundëm të gjejmë dokumentacion në numër të madh që ta vërtetojë një gjë të tillë, por megjithatë janë gjetur disa të tillë.

I - Duke marrë për bazë dokumentin arkivor të Redaksisë së tekstit të “*Historisë së Letërsisë Shqipe*”, ku kërkohet *opinion* i diskutuesve mbi disa auctorë¹⁶, ndër të cilët është i përmendur edhe Gjergj Fishta, gjë që bëhet për t’u dhënë vendin që u përket në *historinë e letërsisë*¹⁷, mund të vijmë në përfundim se ka pasur ndihmë, por edhe ndërhyrje në përpilimin e kësaj pjese të *Historisë së Letërsisë Shqipe*, por edhe të Fishtës, në veçanti.

II - Përmirësimet dhe ndërhyrjet dëshmohen edhe në recensionin e Nasho Jorgaqit, recension ky i vitit 1965, ku pjesa për Gjergj Fishtën fillohet me:

¹⁶ Redaksia e tekstit të “*Historisë së Letërsisë Shqipe*”, *Mbi diskutimin e periudhës 1912 – 1939 të Historisë së Letërsisë Shqipe*, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, f. 2.

¹⁷ Redaksia e tekstit të “*Historisë së Letërsisë Shqipe*”, *Mbi diskutimin e periudhës 1912 – 1939 të Historisë së Letërsisë Shqipe*, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, f. 2.

*Ky kapitull ka pësuar përmirësime pas ripunimit të parë. Janë evituar kontradiktat që viheshin re më parë, pasaktësitë, ekuivoket.*¹⁸

Në recension vazhdohet edhe me një sërë sugjerimesh të reja, si: shtimi i faktit të botimit të artikujve profashistë në Itali; të flitet më tepër për dramën e Fishtës; si dhe dy vërejtje të tjera që janë çështje shprehimore.

Çështja e nivelit të ndërhyrjes, ndryshimeve dhe arsyeve që fshihen pas saj, si dhe mosbotimi i monografisë së përfunduar më 1961, mbeten çështje për diskutim dhe hulumtim.

Kapitulli për Gjergj Fishtë në *Historinë e Letërsisë Shqipe 1912 – 1939* mbetet i vetmi në këtë lloj librash, përpiluar në mënyrë institucionale. Me gjithë ndërhyrjet e mundshme, variantet e gjetura, si dhe vetë kapitulli janë një thesar që hedhin dritë të re mbi pikëpamjen e censurës në Shqipërinë komuniste.

BIBLIOGRAFI

Hoxha Beqiri, B., *Një histori letërsie e ndaluar; Si u ripërkthet Fishta, Konica dhe Skiroi nga "Historia e letërsisë shqipe"*, SHB Naimi, Tiranë.

Diskutimet mbi maketin e *"Historisë së letërsisë shqipe"*; *Vërejtje të përgjithshme*, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë.

Dokument arkivor; Dosja, titulli *Gj. Fishta (kapitulli i tekstit të letërsisë)*, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë.

Dokument arkivor; Versioni I i kapitullit për Gjergj Fishtë, 83 faqe (faqe edhe me vetëm daktiloshkrim) Versioni II i kapitullit të Gjergj Fishtës, 57 faqe, si dhe Versioni III i kapitullit për Gjergj Fishtë, 47 faqe (kopja 1), Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë.

¹⁸ N. Jorgaqi, recensionin *Për Historinë e Letërsisë Shqipe të periudhës 1912 – 1914* (gabimi në titull është në dokument), 9 qershor 1965, Tiranë, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, f. 6.

Historia e letërsisë shqipe 1912-1939, dorëshkrim; Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, f 132.

Redaksia e tekstit të “Historisë së Letërsisë Shqipe”, *Mbi diskutimin e periudhës 1912 – 1939 të Historisë së Letërsisë Shqipe*, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë.

Jorgaqi, N., recensionin *Për Historinë e Letërsisë Shqipe të periudhës 1912 – 1914* (gabimi në titull është në dokument), 9 qershor 1965, Tiranë, Arkivi i Institutit të Gjuhës dhe Letërsisë, Tiranë.

Bala, V., *Gjergj Fishta; Jeta dhe vepra, Shkodër 1961*, Shtëpia Botuese Ombra GVG, Tiranë, 1998.

Bala, V., *Monografi mbi Gjergj Fishtën*, i daktilografuar, 154 f., Shkodër, 1961, Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë.